




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Nr. 01-325/04-0031367/25
Data 09.08.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), neni 17 paragrafi 1, shkronja g) dhe neni 40 paragrafi 1 dhe 2 shkronja l), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, konform Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, ndërlidhur me nenin 90 paragrafi 1 dhe 3, të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, dhe neni 14 par. 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 31.07.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

(Për miratimin e raportit përfundimtar, të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara kryesisht nga Era, Zjarri, për muajt Janar – Qershor 2025)

Neni 1

Miratohet propozim-vendimi me Nr.02-052/01-0027799/25, i datës 11.07.2025, Për miratimin e raportit përfundimtar Nr.09-052/01-0026407/25, të datës 07.07.2025, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera (erë, zjarre) për muajt Janar – Qershor 2025. Dëme janë shkaktuar në bujqësi dhe në ekonomi familjare, në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale prej **217,481.49€**.

Neni 2

Me miratimin e këtij vendimi, miratohet raporti përfundimtar i dëmeve i cekur në nenin 1, i shqyrtuar nga kryetari i komunës, përmban një vlerësim profesional nga të dhënat e evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vendshikim të komisionit paraprak të emëruar nga kryetari i komunës dhe kërkesave për kompensim të dëmeve nga qytetarët (familjet) e dëmtuara nga erërat, breshëri dhe fatkeqësitë e tjera të cekura në nenin një, dhe i njëjti raport me miratimin në kuvendin komunal në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit i dorëzohet Agjencisë së menaxhimit emergjent, dhe një kopje të njëjtësuar Komisionit Qendror të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 3

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë: Kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Komisionin Profesional Komunal mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 30 dite pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb-faqen e komunës.

Bashkëngjitur: Raporti përfundimtar Nr.09-052/01-0026407/25, të datës 07.07.2025, Lista e fermerëve të vlerësuar dhe Vendimi bazë i komisionit komunal Nr.02-020/01-0030478/23, i datës 21.06.2023, i plotësuar dhe ndryshuar me vendim Nr.02-020/01-0034210/23, të datës 12.07.2023, dhe Vendimi Nr.02-020/01-0043987/24, i datës 09.09.2024, si dhe Vendimi Nr.02-020/01-0011682/25, i datës 28.03.2025.

Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit;
- 1x1 Zyrës së Kryetarit;
- 1x1 AME-së;
- 1x1 MAPL-së;
- 1x1 Dosjes.

